

VIRION GRAÇI

PËRSHFAQJA E SKËNDERBEUT TE ETËHEM HAXHIADEMI DHE TË TJERË AUTORË SHQIPTARË

1. Dramaturgjia e Etëhem Haxhiademit dhe skena e asaj kohe

Krijimtaria letrare Etëhem Haxhiademit, e dënuar me heshtje dhe ndëshkime të skajshme përgjatë gjysmës së dytë të shek. XX në Shqipëri, del e plotë në dritë për njohje dhe studim këto kohë falë bashkëpunimit “Botimet Poeteka” dhe familjes së autorit. Etëhem Haxhiademi, edhe vetë personazh tragjik në historinë e Shqipërisë komuniste, i dënuar padrejtësisht, është dalluar në vitet tridhjetë mes krijuesve, përkthyesve dhe intelektualëve të tjerë. Ajo epokë e ka dashur E. Haxhiademin, ka mirëpritur punën e tij, ka pranuar me natyrshmëri personalitetin e tij, talentin, protagonizmin e tij si qytetar e si shkrimtar. Pajisur e formuar sa me kulturën klasike, aq dhe me kulturën bashkëkohore-europiane, ai synoi të sjellë në shqip kryevepra nga fondi botëror i letërsisë, sikurse nga ana tjetër, në harkun kohor të dhjetë viteve, afërsisht, shkroi e botoi një sërë veprash për skenë, tragjeditë mitologjike si “Ulisi”, “Akili”, “Diomedi”, dhe ato me temë historike si: “Aleksandri”, “Pirrua”, “Skënderbeu” dhe “Abeli.”

Në vitet ’30 Etëhem Haxhiademi është pranuar dhe përshëndetur nga autoritet letrare si autor i ri, me talent të veçantë, zë i përveçëm dhe i shquar, jo vetëm në brezin e tij. Vangjo Nirvana (Vangjel Koça) duke përcjellë me një analizë paraqitëse të karakterit psikologjiko-historik tragjeditë “Ulisi”, “Akili”, “Aleksandri” shprehet:

Këto janë të tri tragjeditë e para të Haxhiademit, që, me gjithë të metat e tyre – se dhe kryeveprat akoma kanë të meta, kanë cilësi që e nderojnë zotësinë dhe inspiratën e autorit të tyre, dhe janë një prodhim i vyer në leteraturën e sotme të brezit të ri.

Vlerësim më i lartë i bëhet autorit të ri E. Haxhiademi nga Gjergj Kuka, kur shprehet:

Në radhët krenare të shpatëtarëve të literaturës së re shqiptare, ai ecë me ball të lidhun me dafinat e nderit. Shkrimtarë të temperamentit të Haxhiademit s'kanë nevojë për lëvdata mbasi e kanë fitue me mundime të vazhdueshme vendin e tyne në literaturën Shqiptare.¹

Për shumë arsye, nga veprat e tij origjinale, ende sot, më e rëndësishme mbetet tragjedia “Skënderbeu”. Botimi i tragjedisë “Skënderbeu” (Shtëpia Botonjëse “Kristo Luarasi”, Tiranë, 1935) ka qenë ngjarje e shënuar në jetën kulturore të kohës, është pritur me shkrime përshëndetëse nga intelektualë të dalluar si Branko Merxhani², Aleksandër Xhuvani³, Behar Shtylla⁴ (me

¹ Gjergj Kuka, “Nji polemikë letrare rreth tragjedisë “Skënderbeu” nga Etëhem Haxhiademi” në revistën *Përpykja shqiptare*, nr. 8, viti I, faqe 122.

² Branko Merxhani, “Studime historike nga pikëpamja sociologjike”, *Illyria*, 4-18 prill, 1936.

B. Merxhani shprehet: *Vlen të shënohet edhe libri më i fundit dhe më i bukur i Dramaturgut t'onë modest Etem Haxhiadem-it “Skënderbeu”, tragjedi me pesë akte, Tiranë, 1935. Fytra e çuditëshme e Fatosit t'onë legjendar, simbolizon typin e e njeriut tragjik të cilit nuk i mungon elementi demoniak për të frymëzuar tragjedinë më të goditur, jo vetëm të jetës së tij private, por edhe të mjerimeve historike të së gjithë jetës së popullit shqiptar. Vepra e Haxhiadem-it, që zë vend të posaçëm në botimet e vitit të kaluar, është prova e parë guximtare për të krijuar një Typologji të shpirtit rreth Epokës karakteristike të Skënderbeut. Fatosi ynë kombëtar, ky burrë i math me origjinën e ti shqiptaro-slave, me edukatën bizantino-islamike dhe me shpirtin e shqiptarit të kulluar ‘par excellence’ produkt gjigant i Mythit primitiv të Malsis s'onë, është Titani, që ngreh lart grushtin e vet kunderejtë dënimit të*

pseudonimin Bardhi Shtylla), Vangjel Koça (me pseudonimin Vangjo Nirvana⁵), Jup Kastrati⁶ etj.

Duke përkujtuar autorin, duke u përpjekur të gjejmë afërsisht vendin e tij në historinë e letërsisë sonë, etiketimi i parë që të shkon në mend është ai që vetë autori do ta kishte ëndërruar: “themelues i tragjedisë shqipe”. Dhe siç do ta shohim më tej, në atë periudhë është ndier nevoja për të pasur një teatër kombëtar në dobi të edukimit qytetar, estetik dhe atdhetar të njerëzve të zakonshëm. Në historinë e dramaturgjisë shqiptare këtë vend, “themelonjësi i tragjedisë shqipe”, Haxhiademi e ka merituar. Por parimisht, nga dramaturgjia e shkruar te historia e teatrit si histori repertori teatror, si kategori historike, si fenomen social-kulturor

fatit, që i tyranozoi qysh prej shekujve Gjenin t'onë dhe që i ka mbyllur, më zemërim e keqdashje udhën e madhëstisë s'onë mun në prakun e historisë.

³ Aleksandër Xhuvani, “Një tragjedi e re shqipe”, *Illyria*, nr. 37 dhe 38, Tiranë, 1936, fq. 3-4: *Sikurse tragjedijat e tjera t'auktorit edhe kjo, Skënderbeu, ka frymë klasike: ndahet në pesë akte, ka pak persona dhe në të thururit e gjithë lëndës ruhen rregullat klasike të artit dramatik. Z. Etëhem Haxhiademit, admiratorit të klasicizmit, i pëlqen me hartue jo drama, por tragjedi. Auktori asht i pari ndër ne që ban tragjedi me vlerë e me teknikë. Ai ia ka marrë dorën mirë hartimit të tragjedijajavet klasike, asht ba, arak në ket punë dhe ia ja qëllon mirë punës mbas mendjes s'eme.*

⁴ Bardhi Shtylla, “Tragjedit e Haxhiademit”, *Shkëndija*, nr. 4, Tiranë, 1994, f. 123-136, shprehet: *Maturiteti artistik i autorit duket në sqenat korneliane, në përpilimet e thella të karaktereve kryesorë Skënderbeu e Zanfina, karaktere të pa krahasueshëm në mes tyre për cilësi.*

⁵ Vangjo Nirvana, “Viti mendor 1936”, *Përpjekja shqiptare*, nr. 4, 5, 6, 1937: *E Haxhiadami me “Skënderbeun” hyri në histori, po me “Diomedin”, u kthye prapë në mythologji. Me “Skënderbeun” preku një çast dramatik të jetës së Heroit t'onë Kombëtar dhe dijt t'a zhvillojë në teknikën e tij të përparuar. Me “Diomedin” vuri përballë dashurinë, krimin, urrejtjen, pasione njerëzore të cilat i zhvillon me një dramaticitet të gjallë.*

⁶ Jup Kastrati, “Dramatika shqiptare”, *Revista letrare*, nr. 12, Tiranë, 1944, 1 gusht, f. 6-7: *Fill mbas tragjedisë (Pirrua) Haxhiademi na fal një tragjedi tjetër: “Skënderbeu”. Në këtë mes, dramaturgu i ynë nuk ka të bajë ma me mitologji helenike dhe me histori të kohës së vjetër, por vetëm e vetëm me heroin tanë kombëtar.*

– shumatore shfaqesh të suksesshme dhe rikonfirmimesh përtëritëse të pjesëve teatrore nga njëri brez në tjetrin, rruga është e gjatë dhe misioni mbetet i papërbushur, fatkeqësisht. Në këtë rrafsh, pra, një trashëgimi teatrore si lëndë e parë e objekt pune kryesisht për studiuesit, për historianët e letërsisë dhe të gjuhës shqipe, prurjet prej debutuesi në një zhanër autoritar si tragjedia, institucion shpirtëror e moral për më tepër se dy mijë e pesëqind vjet në jetën e popujve të Mesdheut, mund të arsyetohen e të pranohen relativisht brenda sistemit letrar shqiptar të asaj kohe. Prandaj e vendosim në kontekstin përkatës tragjediografisë e tij, rëndësinë e saj të çmueshme si meritë e autorit Haxhiademi, dhe kufizimet – si kufizime vendimtare të traditës si mungesë dhe të horizontit pritës.

Le të kthehemi në vitet '30-të. Vedad Kokona në “Theatri dhe ne” shprehet:

Në një vend ku përqindja e analfabetizmës ndodhet në një shkallë t'atillë sa njeriut i vjen me të vërtetë keq, ku turma e verbër ngryset e gëdhiet përpara tavllës apo xholit duke pirë duhan e duke zënë njëri tjetrin në gojë ose ku edhe ata që dinë këndim e shkrim nuk të zënë kurrë një libër me dorë, theatri duhet të lozë kryesor në edukimin e popullit; të jetë një shkollë e vërtetë ku, herë pas here, edhe ay më i humburi që rron në llomin e jetës, të ketë mundësinë të jetojnë në një atmosferë fisnike dhe qytetëronjëse. Mjerisht ndër ne, edhe pikërisht ndër ne ku ndjehej nevoja më shumë se në çdo vend tjetër, theatri nuk e ka lozur këtë rol me rëndësi dhe ka mbetur dhe sot e kësaj dite, në mes të shekullit të njëzet dhe në një vend që është një urë mes Lindjes e Perëndimit – ka mbetur, themi, në fazë aq embryonale aq sa, mund të thuhet pa pikë hezitimi, se në lëmin theatror asnjë tentativë serioze nuk është bërë në vëndin t'onë.⁷

⁷ Vedad Kokona, *Revista Letrare*, Tiranë, 1944, nr. 4, 1 prill, f. 1.

Muhamet Bala në “A kemi një dram modern shqiptar?” shënon:

Pse popull i vogël e gadi gjithmonë nën zgjedhë të huej, pse përherë i nëpërkamun prej amnikut të pashpirt e gjakpirës, Shqipnija, s’pat rase me njoftë mirë e me hye për palc, deri vonë, jetës mendimtare e hartistike të huej: Ky asht zakonisht fati i të gjithë kombeve të vogjël.⁸

Po aty vazhdon:

Ndijësija e Bukuria kanë nisë me u përvetësue mjaft prej nesh. Na kemi një epikë. Kemi një folklorë. Lirika vazhdon gjithnjë tue u mprehë e tue u hollue sa ma tepër. Novella s’na mungon, madje një novelë në kuptimin e vërtetë të fjalës. Romanxi vazhdon me u zhvillue me hapa të shpejtë. E dramatikja? Dramatika ka mbetë me gjith se populli asht i ethshëm për teatro. Shpesh dëgjoj zane si: “Jemi lodhë ma prej dramave historike. Mjaft me drama me shtjellime të kalueme... Kur do të shohim ma një dramë të kohës?...dramë e kohës, me sensibilitete të ditës, personazhe me petka qytetare....

Fiqret Fterra “Për një ritrajtim theatror”, në sythin “Shkrimtari e theatri”, vëren se “për popullin t’onë vlera e theatrit, nuk do të kufizohet vetëm si qendër edukimi por do të ndreqi një urë të fortë, e cila do të lidhi kulturën me turmat... (shkurtimi im: V. G.).⁹

Në këto dhjet vjetët e fundit, theatri ynë a ka bërë ndonjë përparim? Po t’a shqyrtojmë, në bazë të numrit të çfaqeve, në vend përparuar jemi në dekadencë. Të gjithë mbajnë mend pa a

⁸ Muhamet Bala, *Kultura Islame*, Tiranë, 1942, nr. 5-6-7, Kallnuer, f. 214-217.

⁹ Fiqret Fterra “Për një ritrajtim theatror”, *Shkëndija*, Tiranë, 1943, 8-9, qershuer-korrik, f. 44-47.

*shumë se përpara pak vjetëve, në Shkodër, Korçë, Tiranë ndihej një etje dhe vlim për theatër, dhe çfaqet ndonëse me shumë të meta artistike prapë ishin të shpeshta ashtu edhe në Elbasan, Vlorë etj.*¹⁰

Sa i përket repertorit të huaj, që mund e duhet të përmbushë nevojat estetike të çdo publiku, F. Ftterra bën një vëzhgim interesant, një qortim me vend:

*Kemi pasur rastin të shohim personazhet e komedive të Molier-it të mveshur me brekushe e me një tufë presh në duar; ose tjerë aautororë të huaj, të përmëndur, personazhët e të cilëve, dilnin në skenë me këmisha nate (një lloj pizhame) e me faqore të rakisë nëpër duar, duke u unjur këmbëkryq mbi rrogozë.*¹¹

Në një mjedis të tillë mungesash e nevojash të jashtëzakonshme kanë ardhur tragjeditë e E. Haxhiademit. Duke lexuar me kriterë të zhanrit “Skënderbeun” e tij, mund të themi se jemi larg zhanrit. Jemi në zhanër sa i përket anës formale, mënyrës së rrëfimit, organizmit të lëndës në akte, në skena, zbulesës së personazheve nëpërmjet dialogimit, trialogimit, jemi në zhanër edhe sa i takon fundit me vrasje a vetëvrasje personazhi; kurse pjesa përmbajtjesore, konflikti i madh ideor e botëkuptimor i përfaqësuar nga të paktën dy protagonistë, nga dy autoritete rivalizuese në planin etik, nuk e ka intensitetin dhe sublimimin e domosdoshëm; idealet e reja, kumtuar nga heroi i cili sakrifikohet me vetëdije për t’i mbrojtur e afirmuar ato nëpërmjet flijimit të tij heroik, janë jehona faktesh dhe hamendësimesh, por jo vetëdije e re ekzistenciale që kërkon e meriton të fitojë të drejtën e qytetarisë. Nisur nga numri jo dhe aq i bollshëm i tragjedive në traditën botërore të teatrit, parë me

¹⁰ Po atje.

¹¹ Po atje.

kriteret e nënkuptuara dhe funksionet e tragjedisë si zhanër, nga “Poetika” e Aristotelit e këndeje, do të kishim tragjedi, katarsis, nëse Skënderbeu ose një i ngjashëm i tij do të humbiste jetën duke i artikuluar idealet e veta përkundër forcave rivale, madhore etj. Parë edhe me sytë spektatorit të teatrit klasicist, me të cilin e kanë njësuar dramaturgjinë e Etëhem Haxhiademit bashkëkohësit diturakë si Branko Merxhani me të tjerë, do të zbulonim largime edhe nga ajo paradigmë teatrore. Dhe nuk janë nga ato largime krijuese-novatore që e pasurojnë zhanrin, i sjellin risi, i sjellin zbulesa domethënëse brendish njerëzore dhe galerisë së personazheve letrare i shtojnë tipa origjinalë, me domethënie të fuqishme social-filozofike e etike. Nga praktika e teatrit klasicist gjejmë të mishëruar vetëm vizatimin e personazheve bardhezi, të pandryshueshëm në rrjedhë të ngjarjeve, si dhe përfundimet tepër të arsyeshme për të qenë zgjidhje konfliktesh tragjike, që do të thotë, artificiale, *deux ex machine*. Por këto të fundit nuk numërohen si të arritura të atij teatri, përkundrazi, hyjnë te mangësitë, te nënshtrimi ndaj dogmave teorike. Veç pritshmërive të sipërcekura të pjesëve që janë titulluar tragjedi, është dhe një kriter thelbësor që e dallon tragjiken/ dramatikën nga zhanret e tjera letrare: protagonistët veprojnë e nuk rrëfejnë. Ky raport, pra, midis veprimit të personazheve, si mjet afirmues i tyre dhe nga ana tjetër, e rrëfimit për vetveten, është tregues që e cilëson veprën, e klasifikon atë.

Më shumë se tragjedi, “Skënderbeu” i Etëhem Haxhiademit është një panegjirik e shquar për heroin tonë kombëtar. Autori dramatizon në mënyrë mjaft të thjeshtëzuar disa episode të diskutueshme që kanë lidhje me mënyrën e lidhjes së martesave dhe tradhtitë e princërve/ ushtarakëve madhorë të arbit, bashkëlufëtarë ose familjarë të Gjergj Kastriotit. Oborri mbretëror, Gjergj Kastrioti dhe shpura e tij janë maja e shoqërisë dhe problemet, gjakimet e tyre vlejné të mishërohen vetëm në zhanrin e lartë, që është tragjedia, sikurse E. Haxhiademi ka bërë. Po ashtu, gjuha e përdorur është në përshtatje me personazhet e

sërës së lartë dhe me zhanrin: është gjuhë poetike, mbizotëron retorika, fjalori i përzgjedhur me kujdes dhe elokuenca në dialogim. Secila shprehje karakterizon madhështinë e Gjergj Kastriotit, urtësinë e tij, trimërinë e pashoqe, shpirtgjerësinë, virtytet, rëndësinë si prijës kundër Turqisë etj. Këto e të tjera si këto, deklarohen/ rrëfohen e nuk shfaqen, nuk vijnë përmes veprimit dramatik. Konflikti ndjenjë – arsye nuk ndodh, nuk është në plan të parë sepse mbizotëron arsyeja dhe panegjirika. Nuk është hedhur në fushën e sprovës simboli, garantuesi dhe mishërimi më i lartë i cilësive njerëzore dhe shtetërore, Gjergj Kastrioti. Vend kryesor ka zënë sqarimi i lexuesit/ publikut se Hamzai, Moisiu, Zanfina ishin të zemëruar me mbretin Skënderbe, por ishin të zemëruar për arsye meskine, karriere, lakmie apo nga ndjenja të tjera inferioriteti përballë fatosit të Shqipërisë, mbretit të Shqipnisë. Pjesa është, mbi të gjitha, glorifikim i Skënderbeut dhe historisë së tij në sytë shqiptarëve të zakonshëm të viteve '30. Bie në sy përdorimi i thirrurëve, si p.sh. “Mbret i Shqipnisë”, si dhe përsëritja e shpeshtë e fesë, nënvizimi se jemi tjetër fe me turqit. Në fundin e arsyeshëm (sipas poetikës klasiciste të tragjedisë) kemi Skënderbeun:

SKËNDERBEU

*Si don qi t'jet tradhtija e 'tij mbaroi,
 Porse tradhëtia e Hamzait filloi.
 Filluëm të msohem na me pun' t'këqija
 Dhe si po shoh e mjer' do t'jet' Shqipnija.
 Por un deri sa t'rroj nuk do t'kursehem
 Për t'mbrojtur tokën t'ime qi ushqehem.
 Barbarit të tërbuëm sa të jem gjallë
 Do t'i vërsulem rreptësisht me pallë
 Dhe gjak' i im bregoret do t'i lajë
 Qi t'rroj Shqipnija, dhe flamur' i sajë!¹²*

¹² Etëhem Haxhiademi, *Skënderbeu*, Botimet “Poeteka”, 2020, f. 100.

Me “Skënderbeun” e E. Haxhiademit jemi përsëri në frymën e epikës-romantike rilindëse, krahas emrave të mëdhenj si Jeronim de Rada e Naim Frashëri, krijimtaria e të cilëve më së pari, kur lëvronte këto subjekte, kishte patos edukativ-atdhetar. Ja si e fillon Naim Frashëri gati gjysmë shekulli përpara Haxhiademit:

*Këndo, ëngjell, urtësinë
Edhe gjithë mirësitë,
Skënderben' e trimërinë,
Q'i dha Shqipërisë dritë.
Të lumtë goja, këndona,
Me gjuhë të ëmbël si mjaltë,
Skënderben'e madh tregona
Trimnë burrë, Zotn' e naltë.
Punëtë që ka punuar
Kordhëtari i vërtetë
Kombin duke nderuar
Dhe Shqipërinë përjetë.*¹³

Ngjashmëria mes vargjeve të mësipërme të Naimit dhe vargjeve të marra nga E. Haxhiademi, është simetrike. Haxhiademi ka përkthyer në gjuhën specifike të një zhanri tjetër të njëjtin imazh, të njëjtën frymë. Dhe kjo është vlerë e çmueshme e tij. Karakteri agjitativ, didaktika patriotike në dramën shqipe të gjysmës së parë të shek. XX, dëshmuar mjaft te “autori ynë”, janë të kuptueshme dhe të pashmangshme, ndonëse në gjini të tjera letrare, si: tregim, novelë, poezi, kapërcimi në fushën e artit të kulluar kishte ndodhur në emrat më përfaqësues, në veprat më përfaqësuese.

¹³ Naim Frashëri, *Vepra letrare 4*, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, 1996, f. 13.

2. Tragjedia “e vërtetë” e Skënderbeut në letërsinë tonë

Nga romani “Skënderbeu” i S. Godos lexojmë:

Humbjet e përgjithëshme të Skënderbeut në Sfetigrad arritën në një mijë e tetëqind veta dhe ai u tërhoq me zemrën e ngrirë kur filluan thëllimet dhe bora e nëntorit. Skënderbeu do të fitonte beteja të tjera, të shumta e të mëdha, po nuk do të merrte më asnjë kështjellë. Bedenat e kështjellave kërkojnë kufoma. Ai shikonte përpara. Sulltani kishte humbur në Sfetigrad katër herë më shumë po kjo nuk e ngushëllonte. Fuqia e armikut do të rritej me kohën ndërsa burimet e tij do të thaheshin.¹⁴

Shkëmbi magjik i Krujës qëndroi edhe dhjetë vjet të tjerë pas Skënderbeut... (shkurtimi im: V. G.) Kjo rënie u shoqërua me disa ngjarje që ia bënë vdekjen qytetit po aq të madhe e të rëndë sa edhe jetën që kishte pasur.

Së pari ndodhi sakrifikimi i vajzave dhe i nuseve më të reja... (shkurtimi im: V. G.) Në drekë ndodhi dorëzimi i qytetit dhe Kalasë. Gratë dhe fëmijët u morën rob dhe u vunë në zinxhirë. Për gjithë natën u ngulën qindra hunj rreth e qark mureve të kështjellës. Burrat, gjysmë të vdekur nga uria, mblodhën fuqitë e fundit dhe shkuan te hunjtë. Mehmeti u kishte premtuar jetën dhe lirinë, po ndërroi mendje. Ishte betuar dhjetë vjet më parë, për shpirtin e babait, se do t'i vinte në hunj mbi muret mbrojtësit e Krujës dhe do t'i linte atje të thaheshin në diell. Burrat nuk e kundërshtuan këtë pabesi. S'kishte mbetur më asgjë që t'i jepte jetës një kuptim e një shpresë...

¹⁴ Sabri Godo, *Skënderbeu*, Tirana Times, 2010, f. 123.

*Qyteti i Krujës dhe Kalaja u zbrazën. Banorët që u sollën atje më pas nga vise të tjera, gjetën ndonjë qen a mace të egërsuar.*¹⁵

*– Kthehu nga ke ardhur, o shpirt qeni! – thirri Skënderbeu. Me një goditje pjerrtas ia këputi kokën, që ra përtokë para se të binte trupi. Ishte një nga ato goditjet e vjetra, me forcën e tmerrshme dhe saktësinë e krahut të tij. Ai hodhi një hap dhe me të dytin ia kapërceu të nipit trupin, duke i bërë një poshtërim dhe një mohim që shkonte përtej vdekjes.*¹⁶

*Skënderbeu kishte pritur në male që Mehmeti të ikte. Tani ai kishte ikur, por rrethimi mbetej, i gjithanshëm dhe më i fortë nga sa kishte menduar Skënderbeu. Popullsia pothuaj ishte përgjysmuar. Mijëra njerëz iknin në det me barka të vogla.*¹⁷

Po kështu, S. Godo e shpërndan aureolën e përfytyrimeve romantike për marrëdhëniet e mbështetjen reciproke midis Skënderbeut dhe mbretërive të Europës, marrëdhëniet e idilizuara në retorikën tonë profane midis krishterimit të kohës dhe Gjergj Kastriotit. Qëmtues i fakteve historike dhe jo i retorikës folklorike, Godo jep një pamje realiste, aq sa romani historik si zhanër ia mundëson:

Përfundimet e shtegëtimit që zgjati gati tre muaj, ishin tej inatit dhe dëshpërimit. Në çastin e jetës ose të vdekjes së popullit të tij, Skënderbeu gjendej i vetëm përballë fuqisë së përqëndruar të turkut, i braktisur sheshit e i tradhëtuar. Ai ishte një burrë i vjetër që provoi turpin për herë të parë në dyert e Vatikanit, ku mbeti atje si një fisnik hushkullur që ka lënë vendin e tij dhe s'ka me se të paguajë darkën, ndërsa e

¹⁵ Po atje, f. 498.

¹⁶ Sabri Godo, *Skënderbeu*, Tirana Times, 2010, f. 471.

¹⁷ Po atje, f. 469.

thërrasin në çdo rast ‘mburojë’, ‘shpëtimtar’, ‘Aleksandër i Maqedonisë’, ‘Pirro i Epirit’. E gjitha kjo i shërbente një lodre pa nder. Po tani kjo mori fund.¹⁸

Oliver Jenc Schmid nga ana e tij i mëshon anës tragjike të shqiptarëve të shekullit XIV:

Sado mjeran të ishte fati i këtyre refugjatëve, (refugjatë shqiptarë, shënimi im – V. G.) prapëseprapë ata e kishin shmangur shortin e bashkëatdhetarëv të vet të panumërt, që nuk arritën të shpëtojnë as në anije as në male. Shifrat e të vrarëve e të rrëmbyerve shpesh nuk përputhen. Kështu pas thyerjes së qëndresës së Skënderbeut në bregdet u tha se u vranë 14.000. Vetë Skënderbeu në një letër drejtuar papës Pali II e vlerësonte numërin e të rrëmbyerve në rreth 30.000 vetë.¹⁹

Lexojmë së pari nga Oliver Jens Schmit:

Kështu jeta dhe kryengritija e Skënderbeut u bë dhe tragjedia e trevës së tij të prejardhjes, e cila si asnjë rajon tjetër i Ballkanit u shkretua e u shpopullua nga osmanët. Është gati emblematike në ditët e tij të fundit: hakmarrës i t’et, kundërshtar i dy sulltanëve, atleti i Krishtit, Aleksandri i Ri u ndodh i vetë mbi rrënojat e veprës së tij. Përreth tij ishte ulur në varr një botë e tërë, papët dhe sundimtarët, të cilët i kishin premtuar dhe dërguar ndihmë, fqinjët e tij të krishterë në Ballkanin sllav dhe grek, fisnikë të tjerë të Arbërisë, por sidomos shpura e tij e vogël e besnike e pasuesve. Vetëm bota pas tij nuk deshë të dinte për këtë fat tragjik, ajo dëshiroi një hero ngadhënjimtar në luftën për mbijetesë

¹⁸ Po atje, f. 430.

¹⁹ Oliver Jens Schmitt, *Skënderbeu*, K & B, 2008, f. 378.

kundër perandorisë osmane. Kështu vazhdoi të jetojë Kastrioti i madh si hero vezullues në kujtesë e të krishterëve në Ballkan dhe në Perëndim, ndërkohë që u harrua se ai në të vërtetë ishte figura tragjike e një periudhe kur po ndryshonin kohët.²⁰

Edhe në krijimtarinë e Ismail Kadaresë epoka e Kastriotit ka zënë vendin e duhur. Imagjinata krijuese dhe forca e jashtëzakonshme artistike në ndërtimin e figurave e përshkrimin e situatave nuk e ka penguar autorin të shikojë me ftohtësi përtej metaforave, miteve e romantizmit tradicional kombëtar, si më poshtë:

– Po të bëjmë një llogari të thjeshtë – vazhdoi kryeveqilharxhi, – del se pas pesëqind vjetësh, për shembull, shqiptarët duhet të jenë rreth pesëmbëdhjetë – gjashtëmbëdhjetë milion.

Mevla Celebiu rrudhi ballin sikur ndjeu një dhimbje.

– Kjo, i dashur mik, është një shifër që mund të themi se ta prish gjumin – vazhdoi kryeveqilharxhi. E kupton tani se ç’do të thotë të ndalosh atë që quhet rritje natyrale e popullsisë së një vendi?²¹

Kryeveqilharxhi piu pak sherbet.

Për shembull – vazhdoi ai, – ka një zakon në fiset e shkretëtirës së Arabisë, sipas të cilit, në qoftë se një njeri vritet në grindje e sipër ose në pusi, këtij njeriu patjetër duhet t’i merret gjaku, edhe sikur të kalojnë tre breza. Ky zakon i lidh familjet me zinxhirin e vdekjes. Një zakon i tillë vlen sa shumë beteja të fituara.²²

²⁰ Oliver Jens Schmitt, *Skënderbeu*, K & B, 2008, f. 478.

²¹ Ismail Kadare, *Kështjella*, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, 1976, f. 113.

²² Ismail Kadare, *Kështjella*, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, 1976, f. 114.

Dikush përmendi retë.

– Për fat të keq padishahu i madh nuk i urdhëron dot retë, – tha kryeveqilharxhi duke kundërshtuar Kara-Mukbilin, që ishte kundër sulmit të shpejtë. – Retë mund të shfaqen një mëngjes në horizont dhe një shi i papritur mund të zhdukë etjen e tyre, për të cilën ne u munduam aq shumë.

Shiu. Asnjëherë në jetën e tij nuk e kishte munduar mendjen e Tursun pashait kuptim i shiut, si këto dy javët e fundit. Ajo fjalë e shkurtër, e shëmtuar, e bënte të dridhej. Ai e urrente atë, mendohej ta harronte.²³

Shkrimtari tjetër, Bilal Xhaferi, bashkëkohës me shkrimtarët S. Godo e I. Kadare, e rrëfen lavdinë dhe tragjizmin e epokës në fjalë, por i përmbahet praktikës thjeshtëzuese udhëheqës-popull.

Në Krastakraus Bilal Xhaferri e ndërton në një vepër artistike heroizmin dhe tragjicitetin shqiptar, duke i ikur himnizimit dhe duke iu afruar rrafshit të jetës së zakonshme, për ta parë atë në nivelin e lidhjeve të përditëshme njerëzore e ekzistenciale. Kështuqë, heronjtë e tij letrarë, edhe mbas një mitizimi kauzifolklorik dhe të mitizimeve pa tepriçë, në kujtimet kolektive të shqiptarëve, tash dalin bashkëkohës, të zakonshëm me lakmitë e dështimet njerëzore. Ky njësim i kohëve, apo ky përngjasim i tyre, qoftë dhe në ndërkomunikimet e tyre në një vepër arti, ishin të tmerrshme për kohët e reja mitizuese shqiptare, apo për kohët e rrenave që heroizmin nacional e kishin vetëm perde për të mbuluar realitetin e zymtë njerëzor e etnik.²⁴

Gjergji i tradhtuar nga të gjithë, përveç popullit, i cili është në skllavëri të lumtur, edhe tani popullit i merrej mendja nga uria,

²³ *Po atje*, f. 205.

²⁴ Sabri Hamiti, *Letra shqiptare* 5, Dukagjini, 1996, f. 246.

nga taksat, nga gjaku i derdhur. Pse ai e ngriti në këmbë këtë popull në një gjakderdhje të tillë të tmerrshme?

Vendin e kishin pllakosur shirat dhe dëshpërimi. Nuk ndalej e keqja; sa iknin turqit vinte dimri, sa ikte dimri vinin turqit. Dhe mbi të gjitha në anë të sofrës ishte ulur uria. Një varfëri dhe një mjerim i paparë e kërcënonte popullin.

Krastakraus ishte një fshat i vogël në kreshtën e lartë të Tumenishtit... ata thoshnin me mburrje se edhe qyteti i Krujës nga ky fshat kishte lindur.

Imagjinata poetike e B. Xhaferit kërkon të mbushë tablonë e madhe të së shkuarës për të cilën kërkimet historike, dëshmitë domethënëse, detajet simbolike nuk i ka në masën e cilësinë e duhur. Në përgjithësi, ai i ikën shpesh faktografisë, aq e domosdoshme për stisjen e një romani historik. Gjithsesi, si romancier me vokacion poetik, B. Xhaferi nuk sheh zgjidhje tjetër për udhëheqësin, nuk e hedh në diskutim dobinë kombëtare të qëndresës tij. Në mënyrën e vet, me origjinalitet e ngrohtësi ndërton një përmendore letrare për heroin e tij të dashur.

E vënë në diskutim herë pas here, rëndësia e padiskutueshme e Skënderbeut si mit, si simbol, i ka pasur përgjigjet shkencore pohuese. Do të veçoja për këtë rast arsyetimin e Sh. Sinanit:

Jo miti i Skënderbeut por çmitizimi i tij, i ka shërbyer dëmtimit të një bashkësie, dhe pikërisht dëmtimit të shqiptarëve vetë... (shkurtimi im: V. G.) interpretimi djallëzues i këtyre burimeve përbën dëmin shkatërrimtar ndaj një miti që nuk ka dëmtuar asnjë bashkësi... (shkurtimi im: V. G.) Loja me keqkuptimet, ngatërrimi i qëllimshëm i pravosllavizmit si fe me sllavizmin si ndërgjegje etnike; ngatërrimi i jeniçerizmit me shërbimin e devotshëm, ngatërrimi i gjuhëve dhe shkrimeve që dinte e përdorte Gjergj Kastrioti me kombësinë dhe etnicitetin e

*tij; ngatërrimi i formës ungjillore sllave të emrit të Gjon Kastriotit si del në burimet turke ('Jovan-ili' – tokat e Gjonit) me origjinën e tij, janë instrumente të dështuara të një nisme të çmitizimit të Kastriotëve dhe të epokës humaniste kur ata jetuan, nismë që si shumë të tjera do të dështojë.*²⁵

Duke iu kthyer Naimit, De Radës, Etëhem Haxhiademit e të tjerëve shkrimtarë e poetë të traditës, shohim sërish se i kanë shërbyer më së miri një miti. Dhe ishte pikërisht detyrë poeti kjo e krijimit të mitit. “Poetët krijojnë mite”, – shkruan Sartri. Kurse Northrop Frai e përkufizon mitin si “bashkim të ritualit dhe ëndrrës në formën e komunikimit verbal”. Për E. From-in “Mitet dhe ëndrrat kanë një element të përbashkët, janë shkruar që të gjitha me të njëjtën gjuhë, në gjuhën e simboleve. E drejtuar prej një logjike të ndryshme nga ajo e zakonshmja, pra një logjikë ku kategori sunduese nuk janë hapësira dhe koha, por intensiteti dhe asosacioni, ajo është ndoshta, e vetmja gjuhë universal e krijuar prej njeriut, që ka mbetur e njëjtë për çdo qytetërim dhe përgjatë gjithë historisë”.

Si përfundim, nëpërmjet “Skënderbeut” dhe veprave të tjera të tij, Etëhem Haxhiademi zë një vend nderi në plejadën e viteve '30 të shek. XX. Duke njohur debatet dhe kontributet intelektuale të asaj periudhe, ideologët dhe mendimtarët e shquar shqiptarë të të gjitha drejttimeve politike që po përpiqeshin për një ideologji kombëtare, për një neoshqiptarizëm, për një orientim perëndimor të shoqërisë dhe vendit tonë, për prosperitet kulturor, ekonomik e kombëtar, kuptojmë se E. Haxhiademi, sikurse para tij Naimi, Konica, Noli, Fishta e të tjerë, e ka bërë muzën e tij krijuese dhe bagazhin e tij artistik më së pari shkollë edukimi, forum emancipues, forcë morale për të ndierë krenaritë e trashëguara dhe përgjegjësitë e duhura.

²⁵ Shaban Sinani, *Midis dy Rilindjesh*, Botimet “Naim”, 2010, f. 185-186.